

HAMIT KABA

POLITIKA AMERIKANE NDAJ TË ARDHMES SË SHQIPËRISË (1941-1942)

Karta e Atlantikut dhe domethënia e saj për shqiptarët

Pas mbylljes së misionit diplomatik amerikan dhe largimit të tij nga Shqipëria në shtator 1939, në arenën ndërkombëtare ndodhën ngjarje të tjera të mëdha. SHBA ndonëse e dënuan sulmin e Gjermanisë mbi Poloninë nuk u përfshinë në luftën që sapo filloi. Në fjalimin e tij në radio, më 3 shtator 1939, presidenti i SHBA-ve, Franklin Delano Roosevelt shpalli: “Asnjë burrë apo grua të mos flasë në mënyrë të pamenduar apo të rreme për Amerikën për të dërguar ushtritë e saj në fushat evropiane”.¹ Fjalimi i tij respektonte një sërë aktesh legjislative të Neutralitetit, të ndërmarra me iniciativën e Kongresit që nga viti 1935, të cilat kishin si synim ta mbanin kombin larg luftërave të huaja.² Ndërkohë, Gjermania në pranverën e vitit 1940, pushtoi Belgjikën dhe Holandën, ndërsa Italia e Musolinit u solidarizua me Hitlerin, duke dhënë shenja të qarta se edhe ajo do të hynte së shpejti në luftë përkrah tij. Tre mesazhet e presidentit amerikan të muajve prill-maj 1940 drejtuar Musolinit, për të parandaluar përfshirjen e Italisë në luftë përkrah Gjermanisë dhe Japonisë ranë në vesh të shurdhër.³ Konti Çiano i bëri të qartë ambasadorit amerikan në Romë, se Musolini nuk i pranonte mesazhet që i ishin dërguar nga presidenti amerikan. Refuzimi kishte të bënte me detyrimet që kishte vendi i tij ndaj aleates së vet, Gjermanisë⁴. Ministri i Jashtëm i Italisë do të shtonte edhe një arsye tjetër, faktin që qeveria italiane donte

¹ Franklin D. Roosevelt, “This Nation Will Remain Neutral”, *Vital Speeches of the Day*, September 15, New York: 1939, pp. 712-713.

² Yui Hacho, “The Atlantic Charter of 1941: A political tool of Non-belligerent America”, *The Japanese Journal of American Studies*, No.14, Tokio: 2003, p. 125.

³ *Peace and War: United States Foreign Policy, 1931-1941*, Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office, 1943, p. 73-75. Presidenti Roosevelt i dërgoi Musolinit tre mesazhe: më 29 prill, 14 dhe 26 maj 1940. Thelbi i tyre kishte të bënte me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve botërore përmes negociatave dhe jo luftës.

⁴ Më 1937 Italia ishte bashkuar me Paktin Antikomintern, ndërsa më 27 shtator 1940 ajo do të firmoste Paktin Trepalësh së bashku me Gjermaninë dhe me Japoninë. Shih: *League of Nations, Treaty Series*, vol. CCIV, p. 386.

t'i kishte 'duart e lira' nga angazhimi i presidentit amerikan, dhe çdo negociatë tjetër që nuk ishte në përshtatje me shpirtin fashist.⁵ Përfshirja e Italisë në sulmin ndaj Francës dhe Britanisë në qershor 1940 [akt me të cilin u bashkua edhe qeveria kuislinge shqiptare], zhduku çdo iluzion dhe shpresë për neutralitetin e Italisë. Në tetor 1940, Italia sulmoi Greqinë, ndërsa qeveria kukull e Shqipërisë iu bashkua deklaratës së Mbretërisë Italiane, duke angazhuar edhe disa batalione të çorientuara të ushtrisë shqiptare.

Në prill 1941, Gjermania pushtoi Greqinë dhe Jugosllavinë. Presidenti Roosevelt bëri deklaratatë të forta kundër pushtimit të këtyre dy vendeve dhe u solidarizua me rezistencën e popujve të tyre, duke shpallur njëkohësisht gatishmërinë e qeverisë amerikane për t'i mbështetur ata moralisht dhe materialisht. Ndërmjet vendeve që përfitonin nga akti 'Lend-Lease' [qiradhënie], të miratuar nga Kongresi dhe presidenti i SHBA në mars 1941 ishin edhe dy fqinjët e Shqipërisë, Greqia dhe Jugosllavia. Në këtë listë mungonte Shqipëria, e cila për politikën amerikane zgjonte më pak interes se dy vendet fqinjë, kusht ky i rëndësishëm për të përfituar nga plani amerikan i ndihmave. Ndonëse ishte ndër vendet e para që e pësuan nga agresioni fashist, rezistenca ndaj tij kishte qenë modeste dhe vazhdonte të ishte ende në hapat e parë edhe në vitin 1941. Ndërkohë, imazhi i saj ishte i zbehtë, për shkak se ajo kishte në krye një qeveri kuislinge, e cila ishte bërë palë me Italinë e Musolinit dhe me aktet e saj agresive në botë e në Ballkan.⁶

Miratimi i aktit 'Lend Lease' ndonëse jo zyrtarisht, i renditi SHBA në krah të vendeve antifashiste, ndërkohë që parimisht ajo vazhdonte të ndiqte ende politikën e neutralitetit, të miratuar nga Kongresi për të fundit herë në vitin 1939. Por, meqenëse një pjesë e ngarkesave të destinuar për vendet mike të SHBA, që përfitonin nga programi i lartpërmendur nuk arrinin në destinacion, për shkak të dëmtimit të tyre gjatë rrugës nga sulmet e vendeve armike, Kongresi dhe Presidenti miratuan më 17 nëntor 1941 një rezolutë të posaçme e cila anuloi disa

⁵ *Peace and War: United States Foreign Policy, 1931-1941...*, p. 74.

⁶ Shih: *Fletore Zyrtare*, nr. 93, Tiranë: 10.06.1940. Qeveria shqiptare më 9 qershor 1940 u bashkua me dekretin e qeverisë italiane për t'i shpallur luftë Francës; Shih: *Fletore Zyrtare*, nr. 165, Tiranë: 28.10.1940. Më 28 tetor 1940, sikurse Italia, ajo u deklarua në luftë me Greqinë.

nene të 'Aktit të Neutralitetit'.⁷ Pas kësaj anijet amerikane u lejuan të armatoseshin e mbroheshin nga sulmet armike.

Në gusht 1941, presidenti amerikan Franklin D. Roosevelt dhe kryeministri britanik Winston Churchill mbajtën një konferencë dhe u dakordësuan për të publikuar njëkohësisht një deklaratë të përbashkët në kryeqytetet e dy vendeve. Deklarata, që shumë shpejt do të njihej me emrin 'Karta e Atlantikut',⁸ është një nga dokumentet më të famshme të historisë së Luftës së Dytë Botërore. Ajo paraqet një plan anglo-amerikan prej 8 pikash, të cilat i kushtoheshin periudhës së Luftës e, në mënyrë të veçantë, rindërtimit të botës së pasluftës.⁹ Me miratimin e 'Kartës së Atlantikut', qeveria amerikane i dha fund politikës së pritjes dhe të asnjësisë me fuqitë e Boshtit. Një javë pas takimeve me kryeministrin britanik, Roosevelt i përcolli Kongresit një mesazh për marrëveshjen e arritur me kryeministrin britanik. *Së pari*, ai i bënte të njohur atij se, objekt diskutimesh ishin bërë çështje të natyrës ushtarake e detare, të cilat i shërbenin sigurisë kombëtare dhe objektivave politikë të SHBA. Presidenti theksonte se marrëveshja në këtë fushë do të ndikonte në garantimin e shpërndarjes së furnizimeve sipas programit 'Lend Lease', në favor të vendeve demokratike në Lindje e në Perëndim. Për këtë qëllim, qeveria amerikane kërkoi nga Britania e Madhe që t'i viheshin në dispozicion disa ishuj me rëndësi strategjike, që do të garantonin lëvizjen e anijeve amerikane me furnizime; *së dyti*, Presidenti e informoi Kongresin se ai, së bashku me kryeministrin Churchill po bënin përpjekje për organizimin në të ardhmen e një konference me Bashkimin Sovjetik,

⁷ Ndërmjet tre neneve të shfuqizuara të Aktit të Neutralitetit të vitit 1939, ishte edhe paragrafi 6, i cili i ndalonte Shtetet e Bashkuara që të transportonin ngarkesa në portet e vendeve ndërluftuese dhe të armatosnin anijet e tyre tregtare.

⁸ Deri tani nuk është gjetur ndonjë dokument origjinal i firmosur nga Churchill dhe Roosevelt për Kartën e Atlantikut. Një nga pjesëmarrësit e takimit në Newfoundland, që shoqëronte kryeministrin Churchill ka dëshmuar se nuk ka pasur version përfundimtar të shkruar. Por, pas përpunimit të drafteve është arritur në një version të përbashkët, i cili gjeti miratimin e përfaqësuesve më të lartë të dy shteteve. (Shih: http://en.Wikipedia.org/wiki/Atlantic_Charter). Ky version duket më i besueshëm, sepse takimi i dy të Mëdhenjve dhe vendimi i marrë prej tyre do të kishin rëndësi të madhe për të ardhmen e popujve dhe për vetë rrjedhën e ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore. Formulimi i Kartës së Atlantikut ishte detyrë delikate që kërkonte precizion dhe kohë.

⁹ "Joint statement by President Roosevelt and British Prime Minister Churchill, August 14, 1941", in: *Foreign Relations of United States, 1941, Vol. I, p. 367*. <http://avalon.lax.Yale.edu/wwii/atlantic.asp> (klikuar më 11.06.2009).

që ta ndihmonin këtë të fundit në luftën e tij kundër ‘agresorit kryesor të botës moderne-Gjermanisë’;¹⁰ *së fundi* dhe më kryesorja, ai do të informonte organin ligjvënës të SHBA për marrëveshjen e 8 pikave, të njohur si ‘Karta e Atlantikut’, e cila përmbante parimet bazë për veprimtarinë e shteteve të pasluftës. Tre pikat e para të Kartës së Atlantikut kishin rëndësi më të madhe se të tjerat. Në *pikën e parë*, SHBA dhe Britania e Madhe garantonin shtetet e tjera, se vendet e tyre nuk kishin si synim të zgjerimit teritorret e veta, apo diçka të kësaj natyre dhe të përfitonin nga lufta; në *pikën e dytë*, shprehnin dëshirën për të mos njohur ndryshimet teritoriale, të bëra në kundërshtim me dëshirat e popujve të tyre, dhe *së treti*, se ata do të respektonin të drejtën e të gjithë popujve për të zgjedhur formën e qeverisë nën të cilën ata donin të jetonin, dhe se ata dëshironin të shihnin të rivendosur të drejtën sovranë dhe të vetëqeverisjes, për ata popuj që ishin privuar me forcë prej tyre.

Pikat dy dhe tre të ‘Kartës së Atlantikut’ paraqitnin interes të veçantë për shqiptarët. Në fakt, nyja e dytë e kësaj marrëveshjeje nuk dukej se do t’i favorizonte shqiptarët, sepse pjesa më e madhe e teritoreve dhe popullsisë shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore që ishin bashkuar me trungun amë, pas Marrëveshjes së Vjenës mes dy ministrave të Jashtëm të Gjermanisë dhe Italisë, përkatësisht Ribentrop dhe Ciano, nuk njiheshin sipas kësaj pike. Bashkimi i këtyre teritoreve me shtetin shqiptar binte në kundërshtim me përmbajtjen e Kartës, e cila refuzonte çdo bashkim në rrugë jodemokratike, pavarësisht se këto teritore i ishin shkëputur padrejtësisht Shqipërisë nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Por, nyja e tretë zgjonte shpresat për të gjithë shqiptarët, sepse të dy kryetarët e shteteve të mëdhenj perëndimorë zotoheshin që të respektonin parimin e vetëvendosjes, nga i cili së paku teorikisht, duket se do të përfitonin shqiptarët. Nëse kësaj popullsie do t’i krijohej mundësia të shprehej lirisht dhe të vendoste për fatet e veta, me siguri ajo do të shprehej për bashkimin e saj me Shqipërinë.

Shtetet e Boshtit e perceptuan Kartën e Atlantikut, si aleancë të Shteteve të Bashkuara dhe të Britanisë së Madhe kundër tyre, pavarësisht se ajo nuk i përmendte ata qartazi. Veçanërisht e ndjeshme u tregua qeveria japoneze, e cila gjeti tek ajo motivin për qasje më agresive kundër SHBA dhe Bashkimit Sovjetik. Opinioni publik në Mbretërinë e

¹⁰ Po aty.

Bashkuar dhe i Komonuellthit ishte i kënaqur me parimet e miratuara, por i pakënaqur për faktin që Shtetet e Bashkuara nuk hynë në luftë, gjë që e kishte shpresuar edhe vetë Churchill-i. Nga ana tjetër, opinioni publik amerikan ishte gjithashtu i kënaqur me principet e pranuar, por i shqetësuar nga fakti që SHBA po armiqësoheshin gjithnjë e më shumë me fuqitë e Boshtit, dhe se vendi i tyre po i afrohej gjithnjë e më shumë teatrit të Luftës. Në Kongres ishte ende i fortë opinioni për të qëndruar larg luftës.

Ndonëse 'Karta e Atlantikut' nuk garantonte mbështetje ushtarake për luftën në Evropë, ajo sinjalizoi daljen e lojtarit të madh në skenën botërore - SHBA. 'Karta e Atlantikut', e cila afirmonte parimin e vetëvendosjes, do të shndërrohej në një dokument me vlerë për inkurajimin e forcave të rezistencës kundër diktaturave fashiste. Ajo, gjithashtu, do të zgjonte shpresat e pakicave kombëtare për bashkim me vendet amë. Formulimi i saj krijonte idenë se nga ajo do të përfitonin të gjithë popujt dhe pakicat kombëtare, që po luftonin e po u rezistonin fuqive të Boshtit.

Pas miratimit të 'Kartës së Atlantikut', përfaqësuesit e disa vendeve të pushtuara u mblodhën në Londër, më 24 shtator 1941 dhe morën vendimin për të aderuar në principet e saj. Në takimin e Londrës, ndërmjet të tjerave morën pjesë edhe përfaqësuesit e qeverive në emigracion të dy vendeve fqinjë; Greqisë e Jugosllavisë, madje edhe përfaqësues të Komitetit Kombëtar Çekoslovak. Por, Shqipëria nuk u ftua. Më 27 shtator 1941, vetëm tre ditë pas takimit të Londrës, Mbreti Zog i inspiruar nga 'Karta e Atlantikut' i dërgoi një letër presidentit Roosevelt, përmes së cilës kërkonte që Shqipëria të trajtohej njëjloj me vendet e tjera të pushtuara.¹¹ Zogu sillte në vëmendjen e presidentit amerikan disa të vërteta në favor të tij dhe të vendit që përfaqësonte. Ai nënvizonte se, Shqipëria ishte viktima e parë e agresionit fashist italian në Evropë; se legata mbretërore e Shqipërisë në Paris, pas hyrjes së Italisë në luftë më 10 qershor 1940 e kishte ripërtërirë deklaratën e gjendjes së luftës ndërmjet Italisë e Shqipërisë; se vetë Mbreti Zog i kishte ofruar bashkëpunimin e tij si qeverisë greke ashtu edhe asaj jugosllave, për të organizuar një kryengritje kundër ushtrisë italiane në territorin shqiptar,

¹¹ *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), Roll 15, Target 2. Shënim: Letra ishte shkruar në gjuhën frënge, por ajo gjendet e përkthyer edhe në gjuhën angleze. Letër e Mbretit Zog për presidentin Roosevelt, Nr. 875.01/405, Londër, më 27 shtator 1941.

duke filluar nga muaji dhjetor 1940, por edhe më mbra. ¹² Zogu i kërkonte presidentit amerikan që të shqyrtonte situatën e Shqipërisë dhe t'i jepte mundësinë që të luante lojën e saj në betejën kundër armikut të përbashkët të demokracive. Por, kërkesa e Mbretit Zog për aderim në 'Kartën e Atlantikut' nuk gjeti miratim. Refuzimi i kërkesave të tij për t'u njohur si përfaqësues i ligjshëm i Shqipërisë së pushtuar dhe për të aderuar në aktet e mëdha ndërkombëtare që do të ndërmerreshin gjatë Luftës së Dytë Botërore nga tre të Mëdhenjtë, do të shndërrohej në një refren që do të përsëritej gjatë gjithë kohës së Luftës. Përpjekjet e tij disavjeçare nuk u morën në konsideratë, ndonëse pati edhe mbështetjen e "Vatër", dhe drejtuesve të saj Konicës e Nolit, pothuajse gjatë gjithë periudhës së LDB. ¹³

Deklarata e Kombeve të Bashkuara dhe çështja e aderimit të Shqipërisë në të

'Karta e Atlantikut' shërbeu si bazë për deklaratën e ardhshme të Kombeve të Bashkuara. ¹⁴ Pas përgatitjeve paraprake dhe kontakteve intensive të qeverive të katër të Mëdhenjve [Kina në fakt nuk do të konsiderohet më tej si pjesë e listës së të 'Mëdhenjve', H.K.], u ndërmor hapi i dytë i madh-nënshkrimi i Deklaratës së Kombeve të Bashkuara. Deklarata u firmos më 1 janar 1942 në Washington nga përfaqësuesit e

¹² *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Arkivat Kombëtarë Britanikë*, përgatitur nga Hamit Kaba, Sabit Syla, Instituti "Ali Hadri", Prishtinë & Instituti i Historisë, Tiranë, Prishtinë: 2018, f. 56-67.

¹³ Kërkesat e shqiptarëve për të aderuar në principet e 'Kartës së Atlantikut' dhe të deklaratës së Kombeve të Bashkuara u refuzuan në mënyrë permanente nga tre të Mëdhenjtë. Tre aleatët e Mëdhenj nuk pranuan të njihnin asnjë qeveri të projektuar nga Zogu e 'Vatra', por as edhe nga 'Shqipëria e Lirë'. Qeveritë e tyre i refuzuan gjithashtu edhe kërkesat e Frontit Nacionalçlirimtar, për të njohur dy qeveritë e tij të përkohshme, të krijuara në Përmet e në Berat në vitin 1944. Deklarata e Kombeve të Bashkuara shërbeu si dokument bazë për formimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të krijuar më 26 qershor 1945 nga 50 shtete. Por, Shqipëria mungonte. Përveç arsyeve të tjera, mosqenia e saj në listën e vendeve që firmosën 'Deklaratën e Kombeve të Bashkuara', apo në listën e vendeve që iu bashkëngjitën asaj deri në mbarim të luftës, shërbeu si argument për të mos e pranuar Shqipërinë në organizatën më të madhe e më të rëndësishme të pasluftës. Pasojat do të reflektoheshin ngado, por në veçanti në Konferencën e Paqes të Parisit.

¹⁴ <http://avalon.law.yale.edu/wwii/at17.asp>

qeveritë e SHBA, Britanisë së Madhe, Bashkimit Sovjetik dhe Kinës.¹⁵ Deklarata e Kombeve të Bashkuara afirmonte parimet e ‘Kartës së Atlantikut’ dhe hidhte bazat e një aleance antifashiste të shteteve në luftë me fuqitë e Boshtit. Ajo kishte vetëm dy pika¹⁶: *Pika e parë*, jepte garanci, se çdo qeveri do t’i përdorte të gjitha burimet e veta ushtarake e ekonomike, kundër vendeve anëtare të Paktit Trepalësh, apo kundër çdo ithtari të tyre, me të cilët këto qeveri ishin në luftë. *Pika e dytë*, nënvizonte si kusht - bashkëpunimin e detyruar të qeverive nënshkruese, të cilat nuk mund të bënin armëpushim apo paqe të veçantë me shtetet armike. Deklarata e Kombeve të Bashkuara përfundonte me një shprehje jo shumë të qartë, që i hapte rrugën aderimit të kombeve të tjerë, që nuk kishin qenë firmëtarë të saj, por që mund të bëheshin në të ardhmen, nëse jepnin ndihma materiale dhe kontribuonin në betejën për fitoren mbi Hitlerizmin.¹⁷

Më 2 janar 1942, një ditë pas miratimit të deklaratës së mësipërme nga përfaqësuesit e 4 shteteve kryesore numri i shteteve firmëtarë arriti në 26. Ndërmjet tyre figuronin edhe përfaqësuesit e 8 qeverive evropiane në emigracion, ku bënin pjesë edhe përfaqësuesit e Greqisë, Jugosllavisë dhe Çekosllovakisë. Deklarata u depozitua në Shtëpinë e Bardhë. Në emër të Mbretërisë së Greqisë firmosi Cimon P. Diamantopoulos, për Mbretërinë e Jugosllavisë Constantin A. Fotitch, ndërsa për Republikën Çekosllovake V. S. Hurban. Të dy përfaqësuesit ballkanas u treguan të paduruar për të firmosur sa më parë.

Ajo që binte më shumë në sy ishte mungesa e përfaqësuesit të ‘Francës së Lirë’ organizatës së drejtuar nga gjenerali Charles De Gaulle, e cila kishte aderuar në ‘Kartën e Atlantikut’, që më 24 shtator 1941. Me gjithë insistimin e Churchill-it, as përfaqësuesi sovjetik dhe as ai amerikan nuk qenë dakord që ‘Franca e Lirë’ të përfshihej në listën e vendeve që do të firmosnin Deklaratën e Kombeve të Bashkuara. Në listën e vendeve firmëtarë mungonin emrat e disa qeverive të tjera në emigracion, si ato të vendeve Baltike, të Islandës, Lëvizja ‘Austria e Lirë’ etj. Përgjithësisht, tre aleatët e Mëdhenj u treguan të rezervuar për të njohur si përfaqësues të vendeve të tyre, organizata të kësaj natyre.

¹⁵ *Foreign Relations of United States* [më tej: FRUS], *Diplomatic papers, 1942. General: the British Commonwealth; the Far East*, Volume I, Washington DC: U.S. Government Printing Office, 1942, pp. 25-26.

¹⁶ *Po aty*, p. 25-26.

¹⁷ Kjo pjesë ishte shtuar pas këmbënguljes së qeverisë sovjetike.

Vetëm pak ditë pas miratimit të deklaratës së mësipërme, përfaqësues të disa qeverive apo organizatave antifashiste i paraqitën qeverisë amerikane, kërkesa të veçanta për aderim. Më 6 janar 1942, Mbreti Zog i dërgoi presidentit Roosevelt një telegram me kërkesën për aderimin e vendit të tij në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara. Në të thuhej: ‘Shqipëria aderon zyrtarisht dhe me gjithë zemër në marrëveshjen e njohur si ‘Deklarata e Kombeve të Bashkuara’... Unë, vazhdonte më tej Zogu, i kërkoj qeverisë së SHBA, si vendi i Deklaratës së mësipërme, që të njoftohet për aderimin e vendit tim. Në të njëjtën kohë i lutem Shkëlqesisë Suaj, të pranojë urimet e Shqipërisë së torturuar, për iniciativën e marrë nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe e Aleatëve, për të siguruar triumfin e të drejtave njerëzore e ndërkombëtare”.¹⁸ Teksti i telegramit të Mbretit Zog të krijon idenë se ai nuk e vinte në dyshim njohjen, por thjesht kërkonte që edhe Shqipëria të regjistrohej së bashku me të tjerët në listën e vendeve që e pranonin Deklaratën e Kombeve të Bashkuara.

Zogu e konsideronte veten si autoritetin legal të Shqipërisë, por, rruga nuk ishte aq e hapur sa i dukej. Aleatët e Mëdhenj u treguan të rezervuar ndaj kërkesave të disa vendeve që dëshironin të aderonin në deklaratën e lartpërmendur. Sekretari i Zogut, Sotir Martini bisedoi për këtë çështje pak ditë më pas me diplomatën e Foreign Office, P. Dixon, duke i shprehur dëshirën e Mbretit Zog për të pasur edhe mbështetjen e qeverisë britanike për këtë çështje. Por, P. Dixon në emër të Ministrisë së Jashtme do ta konsideronte të nxituar hapin e ndërmarrë nga Zogu. Atij iu përmend se përkundrazi, FO do ta kishte këshilluar qeverinë e SHBA, se Mbreti Zog nuk gëzon njohjen e saj, dhe se ai duhej të respektonte premtimin që kishte dhënë kur erdhi në Angli, se ai ishte një individ i cili duhej të abstenonte nga çdo aktivitet politik. Dixon ishte këshilluar për këtë çështje edhe me O. Sargent, të cilit i kishte rekomanduar mundësinë e ndalimit të transmetimit të telegramit të Mbretit Zog për presidentin amerikan, gjë që nuk u arrit të bëhej. Aderimi i Shqipërisë në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara u pa me dyshim nga qeveria britanike, sepse lidhej me legjitimitetin e Zogut dhe me të ardhmen e Shqipërisë, për të cilën ajo jo vetëm që nuk kishte ndonjë projekt të qartë në këtë kohë, por ndikohej deri diku edhe nga politika e qeverisë greke në emigracion.

¹⁸ TNA, FO 371/33109, f. 21. Telegram i mbretit Zog për Roosevelt, 6 janar 1942.

Përgjigjja e Presidentit Roosevelt nuk iu transmetua direkt Mbretit Zog. Sekretari i Shtetit, Cordell Hull (Kordel Hull), ia ngarkoi këto detyra ambasadorit amerikan në Londër, Winant. Më 17 janar 1941 Zogut i bëhej e ditur se mesazhi i tij ishte marrë, por nuk jepej asnjë përgjigje nëse ai pranohej apo refuzohej. Roosevelt i shkruante Zogut me terma të përgjithshme: “Unë, i përgjigjem shpresës suaj për triumfin e të drejtave njerëzore dhe drejtësisë ndërkombëtare”¹⁹. Ndërsa sekretari i Shtetit, Cordell Hull i vinte në dukje ambasadorit amerikan, ‘ju mund të shtoni në rrugë verbale, se ende nuk është vendosur ndonjë procedurë për aderimin në parimet e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara, përveç se për ato qeveri që kanë qenë të ftuara më parë’.²⁰

Megjithëse përgjigjja e Roosevelt ndaj mesazhit të Zogut nuk kishte asnjë gjurmë miratimi, qeveria britanike reagoi me shpejtësi. Ajo kërkoi sqarime nga qeveria amerikane për politikën e saj ndaj çështjes së Shqipërisë. Më 5 shkurt 1941, ambasadori britanik në Washington, sir Halifax i transmetoi FO pikëpamjet e Departamentit të Shtetit për këtë problem. Sipas fjalëve të ambasadorit britanik, Departamenti i Shtetit kishte dhënë siguri për Foreign Office, se politika amerikane ndaj Shqipërisë ishte identike me atë të qeverisë britanike, duke theksuar, *së pari*, se qeveria amerikane nuk e angazhonte veten as me Mbretin Zog dhe as me ndonjë lider tjetër për të ardhmen e Shqipërisë; *së dyti*, se ajo nuk e njihte organizatën ‘Shqipëria e Lirë’ të Kostandin Çekrezit, apo çdo qeveri të krijuar nga shqiptarët në Amerikë apo kudo tjetër. Departamenti i Shtetit e kishte bërë krejt të qartë edhe më parë, se ai nuk kishte ndonjë ide paraprake në lidhje me statusin e Shqipërisë pas luftës, dhe se ata ishin përpjekur që përmes gjuhës diplomatike të pengonin ardhjen e Mbretit Zog disa kohë më parë në Amerikë. Përsa i përkiste Çekrezit, vihej në dukje se ai nuk donte të bashkëpunonte me Mbretin Zog, dhe se ai nuk kishte qenë ish komisionar i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara, se lëvizja e tij ishte e vogël dhe që po i përcillnin FO një raport të plotë për aktivitetin e tij.²¹ Mesazhi i Mbretit Zog për të aderuar

¹⁹ *FRUS, Diplomatic papers, 1942*, vol. 1, p. 35. Sekretari i Shtetit për ambasadorin në Mbretërinë e Bashkuar, Winant, 17 janar 1942.

²⁰ *Po aty*.

²¹ *TNA, FO 371/33107, No. 682, f. 29*. Viscount Halifax to FO, 5 shkurt 1942. Në fakt siç dëshmohet nga dokumentet arkivore amerikane Kostandin Çekrezi kreu detyrën e komisionarit të Shqipërisë në SHBA dhe dha dorëheqjen për shkak të vonesave të qeverisë amerikane për të njohur qeverinë shqiptare, detyrë e cila i ishte ngarkuar

në deklaratën e 26 kombeve u konsiderua thjesht si pranim jo angazhues nga presidenti Roosevelt, si një veprim i thjeshtë kortezie në përputhje me zakonet e tij për të respektuar privilegjet e familjeve mbretërore e ish-mbretërore, por pa ndonjë rëndësi dhe pa peshë politike.

Organizata ‘Shqipëria e Lirë’ e kryesuar nga Kostandin Çekrezi e krijuar në dhjetor 1941, i paraqiti Sekretarit Amerikan të Shtetit më 12 janar 1942, një informacion për shoqatën e sapokrijuar, të shoqëruar me kërkesën për njohjen e saj nga qeveria amerikane dhe për solidarizimin e saj me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara.²² Çekrezi u tregua mjaft aktiv dhe u përpoq që të siguronte njohjen e ‘Shqipërisë së Lirë’ jo vetëm nga qeveria amerikane, por edhe nga ajo britanike. Për këtë qëllim, ai i dërgoi ambasadorit britanik në Washington, lordit Halifax, dy telegrame, më 10 dhe 13 prill. Një të tillë ia dërgoi madje edhe ambasadorit kanadez në Washington. Çekrezi jepte shpjegime për qëllimet e organizatës së krijuar prej tij, për shtrirjen në SHBA dhe jashtë saj si dhe refuzimin për të njohur Zogun si drejtues të shtetit shqiptar. Çekrezi mbajti që në fillimet e tij qëndrim kritik ndaj qeverive të vendeve aleate, të cilat nuk kishin dhënë as shenjë më të vogël për statusin e ardhshëm të Shqipërisë. ‘Ne apelojmë përmes jush zoti ambasador për qeverinë e Madhërisë së Tij, shkruante Çekrezi, e cila në të shkuarën ka qenë konsideruar si mbrojtëse morale e Shqipërisë, që t’i japë popullit tonë njohjen e merituar, si një komb aleat i luftës’.²³ Kërkesa për pranimin e Shqipërisë në radhët e shteteve që nënshkruan Deklaratën e Kombeve të Bashkuara iu drejtuan sekretarit Hull edhe nga degët kryesore të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ në qytetet e ndryshme amerikane.

Në politikën e qeverive të tre të Mëdhenjve [SHBA, BS dhe Britanisë së Madhe] në këtë periudhë nuk duket se kishte diferenca, ndaj Shqipërisë. Asnjë prej tyre nuk ishte dakord që Shqipëria të pranohej në Kombet e Bashkuara. Ata kishin qëndrime të ndryshme për njohjen dhe aderimin e disa qeverive dhe ‘Lëvizjeve të Lira’ në Evropë në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, siç ishin qeveritë e ish-vendeve baltike,

Çekrezit. Njohja zyrtare e SHBA për qeverinë shqiptare u arrit më 22 korrik 1922, ndërkohë që qeveritë e Francës dhe Britanisë së Madhe e kishin njohur atë më herët.

²² TNA, FO 371/33107, f. 52. Halifax për Foreign Office, 13 prill 1942; NARA, Roll 15, no. 875.01/421. Letër e Kostandin Çekrezit për Sekretarin e Shtetit, 27 korrik 1942.

²³ TNA, FO 371/33107, f. 46. Halifax për FO, 10 prill 1942.

Komiteti 'Franca e Lirë' e De Golit²⁴, lëvizjet e emigrantëve Katalanas e Baskë, Lëvizjes 'Gjermania e Lirë' etj., por nuk kishin asnjë dilemë ndaj shqiptarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Qeveritë e SHBA, Britanisë së Madhe e Bashkimit Sovjetik nuk i njohën shumicën e 'Lëvizjeve të Lira' të Evropës, të krijuara nga hungarezët, rumunët etj. Përveç të tjerave duket se imazhi i tyre mbeti i cunguar dhe jo aq përfaqësues sa duhej të ishte.

Refuzimi i kërkesave të përfaqësuesve të njohur e të panjohur të disa vendeve evropiane përbënte në fakt problem për politikën e tyre, sepse u duhej të gjenin mekanizma që të justifikonin mospranimin e tyre dhe të unifikonin qëndrimet. Sidoqoftë, ata nuk kishin ndonjë diferencë kur gjykohej për të ardhmen e Shqipërisë, për njohjen e Mbretit Zog, për 'Vatrën' apo për organizatën 'Shqipëria e Lirë'. Në korrik 1942, organizata 'Shqipëria e Lirë' e përfaqësuar nga Çekrezi e përsëriti kërkesën e saj që Shqipëria të pranohej në Kombet e Bashkuara. Kërkesat për aderim iu drejtuan si kryeministrit Churchill ashtu edhe presidentit Roosevelt dhe sekretarit Hull. Çekrezi u përpoq të bindte të Mëdhenjtë se shqiptarët e meritonin të ishin pjesë e Kombeve të Bashkuara, pasi kishin demonstruar unitetin e nevojshëm të tyre, sepse ishin vendi i parë i pushtuar nga Italia dhe se ata ishin angazhuar në luftë me italianët, pa nxitjen dhe mbështetjen e jashtme, ndërsa gueriljet shqiptare, sipas tij kishin hyrë në lidhje edhe me rezistencën e vendeve fqinje.²⁵ Çekrezi i theksonte sekretarit Hull rolin e veçantë që kishte emigracioni shqiptar në Amerikë, si përfaqësues i 'popullit të pagojë', siç i quante ai shqiptarët. Ai nënvizonte prirjen e përgjithshme pro Kombeve të Bashkuara të shqiptarëve si dhe vlerën e rezistencës së tyre në këtë luftë botërore. Ai nuk harronte të përmendte rolin e veçantë të Woodrow Wilson në Konferencën e Parisit, të cilin e quante 'shpëtimtar' të shqiptarëve. 'Kombi ynë proverbialisht xheloz për lirinë e tij, përmendte Çekrezi, është duke pritur një gjest nga Amerika ..., me qëllim që ta hedhë veten me zemër të plotë në betejën e përbashkët kundër të njëjtit armik'.²⁶

Aderimi i Shqipërisë në deklaratën e Kombeve të Bashkuara konsiderohej nga shqiptarët jo vetëm si afirmim i statusit të saj të humbur në

²⁴ Stephen Pope & Elisabeth-Anne Wheal, *Dictionary of the Second World War*, England: Pen & Sword Military Classics, 2003, p. 106.

²⁵ NARA, Roll 15, no. 875.01/421. Letër e Kostandin Çekrezit drejtuar sekretarit amerikan të Shtetit, më 27 korrik 1942.

²⁶ *Po aty*.

vitin 1939, por si garanci për të ardhmen e vendit pas mbarimit të luftës, për t'u përfaqësuar e mbrojtur nga pretendimet e fqinjëve në Konferencën e ardhshme të Paqes. Mungesa e deklaratës për njohjen e shtetit të pavarur shqiptar të pasluftës dhe aderimin e tij në deklaratën e Kombeve të Bashkuara e shtonte frikën dhe dyshimin se Demokracitë e Mëdha do të mbështetnin pretendimet territoriale të fqinjëve të Shqipërisë. Kjo psikozë brenda Shqipërisë u ushqye nga Italia dhe qeveritë kuislingë shqiptare, por nuk mund të thuash se ajo nuk kishte zënë vend edhe tek shqiptarët e Amerikës, Anglisë, tek Zogu, e madje edhe tek miqtë e Shqipërisë në këto dy shtete.

Qeveria dhe presidenti Roosevelt kishin qenë të njohur me dëshirën e shqiptarëve të Amerikës, që vendi i tyre i origjinës të ishte pjesë e Kombeve të Bashkuara. Me dhjetëra kërkesa, letra e telegrame i ishin dërguar presidentit Roosevelt dhe sekretarit Hull nga organizata 'Shqipëria e Lirë', 'Vatra' dhe nga degët e tyre të shumta në qytetet amerikane për pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara. Kërkesa të tilla ishin dërguar edhe nga individë të veçantë të lindur apo të ardhur në Amerikë nga Shqipëria. Ata nuk pajtoheshin me heshtjen e qeverisë amerikane, e cila ende nuk e kishte pranuar kërkesën për aderimin e vendit të tyre të origjinës në familjen e madhe të Kombeve Antifashiste dhe në 'Kartën e Atlantikut'. Këto parime duket se nuk po gjenin zbatim në rastin e shqiptarëve.

Si rezultat, disa degë të organizatës 'Shqipëria e Lirë' në Bruklin, Ohajo, shoqëria 'Dora D'Istria etj., gjatë vitit 1942 i kërkuan Çekrezit, që organizata e tyre të përfaqësonte Shqipërinë në Kombet e Bashkuara. Mungesa e aderimit të shqiptarëve në organizmat e lartpërmendura shqetësoi gjithashtu edhe vatanët, të cilët kërkonin me ngulm, që shqiptarët të përfaqësoheshin në to. Ata kërkuan gjithashtu që parimet e 'Kartës së Atlantikut' të gjenin zbatim, duke njohur përfaqësuesit legalë të popullit shqiptar. Shqetësimet e tyre i përcollën Konica dhe Noli më 19 nëntor 1942, në takimin që patën me Earl Brennan [përfaqësues i OSS-Office of Strategic Services] në Washington. Krahas informimit dhe shkëmbimit të pikëpamjeve dy udhëheqësit kryesorë të shqiptarëve në Amerikë dorëzuan në DSH, një deklaratë të posaçme të firmosur prej tyre. Ata kërkuan nga qeveria amerikane që të pranonte përfshirjen e Shqipërisë në radhët e Kombeve të Bashkuara. Por, thelbin e deklaratës së tyre e zinte kërkesa për njohjen e një qeverie të shqiptarëve në

emigracion të kryesuar nga Zogu dhe prirja e saj për bashkëpunim me qeverinë amerikane.²⁷

M.Ch. Xhagjika një shqiptar i shkolluar për drejtësi në Amerikë i shkruante presidentit Roosevelt më 30 shtator 1942: ‘Akoma Shqipëria nuk është pranuar në familjen e kombeve që kundërshtojnë tiraninë e Boshtit. Pse duhet të ndodhë kjo? Nuk ka dyshim, përmendte ai më tej, se ekzistojnë disa kuislingë në Shqipëri si kudo tjetër, por shumica dërmuese e popullit atje dhe këtu, po bëjnë gjithçka që të ndihmojnë kauzën e përbashkët të Aleatëve’.²⁸ Një tjetër letër i dërgohej presidentit amerikan më 24 tetor 1942 nga Harmonika Çika, një shqiptare e Amerikës e cila e shihte mospranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara jo vetëm si padrejtësi, por edhe me frikë, se Demokracitë mund të pajtoheshin me copëtimin e Shqipërisë nga vendet fqinje. Ajo i referohej dyshimeve të forta të shfaqura pak muaj më parë nga mikja e shqiptarëve-Miss Durham nga Londra në adresë të shqiptarëve të Amerikës, se nëse fitonin Demokracitë, Shqipëria mund të ndahej ndërmjet Greqisë e Jugosllavisë, si shpërblim për përpjekjet e tyre ushtarake kundër fuqive të Boshtit. ‘Mund t’u bëj një pyetje zoti President, shkruante shqiptarja e Amerikës, në fjalimet tuaja ju përmendni të gjithë kombet e pushtuara nga trupat e Boshtit, por harroni të përmendni Shqipërinë. Zhgënjimi dhe ndjenja e shtrengimit të zemrës kap zemrën e popullit shqiptar në këtë vend nga kjo harresë’.²⁹ Ajo e paralajmëronte presidentin Roosevelt, se mirësitë e tyre për këtë vend do të humbitnin nëse copëtohej Shqipëria.

Jashtë kësaj atmosfere nuk mbetën as miqtë e Shqipërisë në Britaninë e Madhe si Miss Durham. Mospërfshirja e Shqipërisë në radhët e Kombeve Aleate u pa me shqetësim edhe nga Miriam Tildeley, e cila më 4 dhjetor 1942 i dërgoi sekretarit Hull një radiogram nga Londra me kërkesën për pranimin e Shqipërisë në radhët e kombeve antifashiste, të cilën ajo e shihte si një gjë plotësisht të merituar, sepse shqiptarët kishin tre vjet që i rezistonin pushtimit fashist. Por, zonjusha Tildesley do të nënvizonte se deri në këtë kohë, Shqipërisë nuk i ishte ofruar asgjë nga Demokracitë.³⁰

²⁷ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/427. Deklaratë e F. Konicës dhe Nolit, 19 nëntor 1942.

²⁸ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/438-1/2. Letër e M.Ch. Xhagjika (Philadelphia) për Presidentin Roosevelt, 30 shtator 1942.

²⁹ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/439-1/2. Letër e Harmonika Çikës për Presidentin Roosevelt, 24 tetor 1942.

³⁰ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/428, PS/LIO. Miriam Tildesley ishte drejtuese e Komitetit ‘Miq të Shqipërisë’ në Londër – shoqatë e afërt me rrethin e Mbretit Zog.

Deklarata e qeverisë amerikane për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë (10 dhjetor 1942)

Karta e Atlantikut dhe Deklarata e Kombeve të Bashkuara zgjuan shpresat e shqiptarëve për ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe të drejtën e tyre për të zgjedhur qeverinë dhe formën e qeverisjes që ata dëshironin. Por, deri në dhjetor 1942 asnjë prej tre Aleatëve të Mëdhenj nuk kishte bërë ndonjë deklaratë zyrtare në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë, ndonëse kjo çështje ishte trajtuar në takime të ndryshme të tyre. Në frymën e principeve të Kartës së Atlantikut kjo ide kishte zënë vend në agjendën e takimit të delegacionit britanik të kryesuar nga sekretari i Jashtëm, Anthony Eden dhe të delegacionit sovjetik të kryesuar nga Stalini, që në dhjetor të vitit 1941 në Moskë.³¹ Më 13 janar 1942, ambasadori sovjetik në Londër, M. Maisky takoi sekretarin e Jashtëm Eden, për t'u informuar mbi politikën britanike në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë. Eden, në përgjigje të ambasadorit sovjetik ritheksoi idenë e ringritjes së shtetit të pavarur shqiptar, por ai do ta sqaronte diplomatin sovjetik se politika angleze deri në këtë kohë nuk ishte detajuar ende. Ministri britanik i kujtoi Maisky-t, se edhe Stalini ndante të njëjtën pikëpamje me britanikët, duke pasur në konsideratë bisedimet e zhvilluara një muaj më parë në Moskë.³² Por, shtoi më tej, se ekzistonte çështja e vështirë e kufijve të shtetit shqiptar me Jugosllavinë e Greqinë, për të cilën, theksoi ai, politika britanike nuk donte ta angazhonte veten në këtë moment. Problemi i dytë që u diskutua ishte ai i Mbretit Zog, për të cilin qeveria britanike u shpreh sërish e rezervuar për njohjen e tij. Ambasadori sovjetik, Maisky shprehu gatishmërinë se edhe qeveria sovjetike do të ecte në një hap me atë të qeverisë britanike për të gjitha këto çështje.³³

Si qeveria amerikane edhe ajo sovjetike ndiqnin trendin e politikës britanike ndaj Shqipërisë. Ato nuk kishin formuluar ende ndonjë politikë të vetën të pavarur dhe të ndryshme nga ajo e qeverisë britanike. Kërkesat

³¹ Oleg A. Rzheshesky, *Stalin and Churchill, Meetings, Talks, Discussions, Documents, Commentaries 1941-1945*, Moscow: Nauka, 2004. pp. 37-38. Shih takimin e delegacionit sovjetik të kryesuar nga Stalini me atë anglez të kryesuar nga Eden, në muajin dhjetor 1941 në Moskë.

³² TNA, FO 536/5, No. 129, p. 30. FO për Kuibyshev, 21 janar 1942.

³³ Po aty, FO 371/33107, No.13. Anthony Eden për S. Cripps (Kuibyshev), 13 janar 1942.

e ardhura nga Mbreti Zog, nga 'Vatra' apo organizata 'Shqipëria e Lirë', që kishin të bënin me të ardhmen e Shqipërisë, trajtoheshin pothuajse njësoj si në Londër ashtu edhe në Washington e në Moskë. Londra vazhdonte të ruante përparësinë në politikën e saj ndaj së ardhmes së Shqipërisë dhe problemeve që lidheshin me statusin e saj të ardhshëm, për shkak të interesit të saj në këtë rajon dhe të njohjes më të mirë të Ballkanit e të Shqipërisë. Sidoqoftë, për politikën britanike në Ballkan, Shqipëria ishte e fundit në radhën e interesave të saj, ndërsa politikës amerikane i mungonte jo vetëm tradita në njohjen e problemeve ballkanike, por edhe interesi i saj për këtë rajon.

Politika amerikane për Ballkanin dhe sidomos për Shqipërinë dëshmonte jo vetëm mungesë interesi, por edhe mungesë përvoja e njohjeje. Ky fenomen, pavarësisht nga angazhimi në rritje i saj nga koha në kohë, bëhet i dukshëm sidomos në vitet 1943 e 1944, kur Departamenti i Shtetit apo institucione të specializuara të tij përgatitën studime të posaçme dhe dhanë direktiva konkrete për Shqipërinë, që kishin të bënin me ngritjen e institucioneve shqiptare të pasluftës, kufijtë e saj, raportet me qeverinë sovjetike dhe ndikimin e saj të ardhshëm etj. Parimet jo gjithnjë përkonin me frymën realiste e pragmatiste të politikës ndërkombëtare. Duket se këto mangësi të politikës amerikane e kishin burimin tek mënyra se si perceptoheshin e zbatoheshin parimet e presidentit Roosevelt për qeverisjen e botës përmes Kombeve të Bashkuara pas mbarimit të LDB, thelbin e se cilës e përbënte ideja e '4 xhandarëve'.³⁴ Kjo ide në dukje e mirë duket se mbartte një lloj romantizmi dhe mungesë realizmi. Ngjarjet e pasluftës treguan se ideja e qeverisjes së botës përmes sistemit të katërshes, nuk ishte funksionale.

Përkundër politikës amerikane, Bashkimi Sovjetik ndërtoi një politikë që kombinonte tradicionalizmin carist me pragmatizmin sovjetik.³⁵ Në vjeshtën e vitit 1942, problemi i të ardhmes së Shqipërisë u bë sërish objekt trajtimi, fillimisht nga qeveria britanike dhe pastaj edhe nga qeveritë e SHBA dhe BS. Në nëntor 1942 në FO mendonin se tashmë kishte ardhur koha për të bërë një deklaratë zyrtare mbi të ardhmen e Shqipërisë. Idenë e saj paraprake për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, qeveria britanike e ndau edhe me qeveritë e dy vendeve të mëdha aleate,

³⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999, f. 408, 412, 420.

³⁵ *Po aty*, f. 417, 427.

të SHBA dhe të Bashkimit Sovjetik.³⁶ Sipas gjykimit të saj, këto dy vende, duhej të bënin deklarata të ngjashme me atë që do të bënte Britania e Madhe. Në një telegram që FO i drejtonte Washington-it më 3 dhjetor 1942, ajo bënte të njohur se kishte ardhur koha për të njohur ringritjen e një shteti shqiptar pas mbarimit të luftës.³⁷

Pavarësisht se qeveria amerikane nuk ndërmori ndonjë hap zyrtar për të ardhmen e Shqipërisë deri më 10 dhjetor 1942, ajo nuk e kishte konsideruar SHBA në gjendje lufte me Shqipërinë, ndonëse qeveria kukull e Shqipërisë nën shembullin e Italisë, u kishte shpallur luftë të gjitha shteteve me të cilat ishte në luftë edhe Italia e Musolinit.³⁸ Këtë qëndrim të qeverisë amerikane e kishte përshëndetur legata shqiptare në Turqi, e cila kishte dënuar, nga njëra anë deklaratën e qeverisë kolaboracioniste shqiptare, që i kishte shpallur luftë SHBA-së, të cilën e përkufizonte si “akt të shëmtuar të Italisë fashiste”, ndërsa nga ana tjetër, falënderonte SHBA, dhe e quante këtë vend “djepin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”.³⁹ Qeveria amerikane nuk e konsideroi vendin e vet në luftë jo vetëm me Shqipërinë, të cilën e njihte si një vend të pushtuar dhe jo të lirë të shprehte vullnetin e popullit të saj, por edhe me shtetet aleate të Gjermanisë, siç ishin Bullgaria, Hungaria e Rumania, të cilat i shihte si vende që u kishin shpallur luftë, jo me iniciativën dhe me dëshirën e popujve të tyre, por thjesht si instrumente të Hitlerit.⁴⁰ Këtë qëndrim të drejtë dhe parimor ndaj Shqipërisë, qeveria amerikane do ta rikonfirmonte sërish në vitin 1944, kur qeveria greke u interesua të dinte nëse qeveria amerikane e konsideronte veten në luftë me Shqipërinë. Përgjigjja e Departamentit të Shtetit ishte sërish negative.

Në dhjetor 1942, tre Aleatët e Mëdhenj ndërmorën aktin më të rëndësishëm të periudhës së luftës, duke deklaruar zyrtarisht njohjen e shtetit të pavarur shqiptar për periudhën e Pasluftës. Iniciativën si dhe më parë do ta merrte qeveria britanike, e cila më 3 dhe 4 dhjetor 1942 kontaktoi për këtë

³⁶ TNA, FO 371/33108. Draft i përgatitur nga Dixon, 5 dhjetor 1942.

³⁷ *Po aty*, FO 371/33107, No. 7584. Telegram i FO për Departamentin e Shtetit, 3 dhjetor 1942.

³⁸ NARA, Roll 15. Më 11 nëntor 1942, Paul T. Culbertson - ndihmësshef i Divizionit të Çështjeve Evropiane, përmendte se ‘qeveria kukull e Shqipërisë i ka shpallur luftë SHBA më 17 nëntor 1941, por SHBA nuk i ka deklaruar luftë Shqipërisë’.

³⁹ *Po aty*, Roll 15. Deklaratë e legatës shqiptare në Stamboll, 20 dhjetor 1941.

⁴⁰ Benett Kovrig, *The Myth of Liberation, East-Central Europe in U.S. Diplomacy and Politics since 1941*, Maryland (Baltimore): The John Hopkins University Press, 1973, p. 360.

qëllim me qeverinë amerikane e sovjetike⁴¹, duke i informuar edhe për arsyet e ndërmarrjes së këtij hapi, të cilat u përmendën më sipër.

Më 30 nëntor 1942, sekretari Hull i paraqiti publikut amerikan në një konferencë shtypi thelbin e deklaratës së ardhshme për Shqipërinë, ndërsa nuk harronte të rikonfirmonte deklaratën e mëparshme të tij për mosnjohjen e pushtimit italian të Shqipërisë të vitit 1939, si dhe të shprehte mbështetjen e qeverisë amerikane për rezistencën e shqiptarëve kundër Italisë. Por, pritshmëritë e shqiptarëve ishin më të mëdha. Ata do të dëshironin një deklaratë të një natyre tjetër, që t'u njihej e drejta e ringritjes së shtetit të pavarur shqiptar dhe pranimit të tyre në familjen e kombeve antifashiste.* Sidoqoftë, Zogu nuk humbi rastin që ta vlerësonte e ta përshëndeste deklaratën paraprake të sekretarit Hull për shtypin amerikan. Më 1 dhjetor 1942, ai i dërgoi një telegram sekretarit amerikan të Departamentit të Shtetit, duke i kujtuar se, rezistenca e armatosur e shqiptarëve ishte e para e këtij lloji në Evropë, por ajo duhej që të zgjerohej e forcohej më tej dhe të pranohej zyrtarisht fakti që 'shqiptarët luftojnë në anën e Kombeve të Bashkuara, në një betejë që është gjithashtu edhe beteja jonë'. Zogu i kujtoi Hull se, SHBA duhej të bënin një deklaratë për pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë.⁴²

Departamenti i Shtetit dhe presidenti Roosevelt deri në këtë kohë kishte marrë shumë letra e telegrame nga shqiptarët jashtë vendit dhe nga Zogu, të cilët kërkonin që qeveria amerikane të prononcohej përmes një deklaratë për njohjen e shtetit të pavarur shqiptar. Por, ajo që është e re në këtë kohë është fakti se një kërkesë të tillë e ndeshim për herë të parë edhe brenda institucioneve amerikane. Më 30 nëntor 1942, sekretari Hull u informua për bisedën e zhvilluar në DSH me zotin Brannon të Zyrës së Shërbimeve Strategjike në Washington.⁴³ Nevoja për të ndihmuar e mbështetur rezistencën në Shqipëri dhe për të gjetur mirëkuptimin e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit e shtyu Brannon që t'i bënte qeverisë amerikane disa rekomandime me shumë interes për të ardhmen e Shqipërisë. *Së pari*, Hull-it iu sugjerua që të bënte një' deklaratë autoritare', që do të

⁴¹ TNA, FO 371/33107, p. 65, 70.

* *Shënim*: Në dokumentacionin e kësaj kohe përdoret termi *Kombe të Bashkuara* në kuptimin e Aleancës së vendeve që luftonin kundër Fuqive të Boshtit. Organizata e Kombeve të Bashkuara e krijuar në prill 1945, pavarësisht nga emërtimi është një gjë tjetër. Mospërfshirja e Shqipërisë në radhët e aleancës së Kombeve të Bashkuara ndikoi negativisht për pranimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

⁴² NARA, Roll 15, nr. 875.01/463. Telegram i Zogut për sekretarin Hull, 1 dhjetor 1942.

⁴³ *Po aty*, Roll 15, nr. 875.01/492. Bisedë e datës 30 nëntor 1942.

favorizonte kauzën e një Shqipërie të pavarur. Deklarata do të lehtësonte bashkëpunimin me gueriljet shqiptare dhe do të mbështeste moralisht shqiptarët brenda dhe jashtë vendit. Departamentit të Shtetit i tërhoqej vëmendja se mungesa e një deklarate të tillë nga qeveria amerikane kishte sjellë dyshime tek shqiptarët, se ‘Amerika nuk i mbështet ata dhe se ‘Anglia preferon ndarjen e Shqipërisë’.⁴⁴ "Nëse mendojnë kështu edhe guerilistit shqiptarë, shkruante Brannon, ka gjasa që ne të na konsiderojnë më shumë armiq se sa miq". *Së dyti*, i kërkohej DSH që në deklaratën e ardhshme për Shqipërinë të shprehej për njohjen e ndonjë ‘Komiteti Shqiptar apo Qeverie në mërgim’, si përfaqësues simbolik të grupeve shqiptare. Duket se specialisti i OSS për Shqipërinë kishte parasysh organizatën ‘Shqipëria e Lirë’, sepse letra e përjashtonte njohjen e një qeverie në mërgim të kryesuar nga Zogu, për shkak se ky i fundit ishte i ‘padurueshëm për shqiptarët’, ndërsa do ta shfrytëzonte njohjen si mundësi për të ‘promovuar pushtetin e tij, për të fituar avantazhe personale’. Nëse Zogut, sipas hartuesit të letrës, i jepej njohja ai do të pengonte mbajtjen e një plebishiti apo kuvendi kombëtar në të ardhmen, përmes të cilit do të gjente zbatim ‘Karta e Atlantikut’ si për krijimin e qeverisë ashtu edhe për formën e qeverisjes në të ardhmen. Për ta bërë më të besueshëm refuzimin e njohjes së një qeverie nën Zogun, Brannon hidheshin dyshime, se ai dhe forcat në shërbim të tij mund të kundërshtonin ndonjë zbatim të mundshëm të forcave aleate në Shqipëri. Arsyeja e fundit se, pse Zogu nuk duhej të njihej kishte të bënte me raportet e tij të këqija me forcat e rezistencës në Shqipëri, në mënyrë të veçantë me Myslym Pezën dhe me Muharrem Bajraktarin.⁴⁵ OSS ishte e mirinformuar për organizatën ‘Shqipëria e Lirë’ dhe zhvillimet brenda saj. Rekomandimet që Brannon i sugjeronte Hull-t përputheshin në esencë me kërkesat e Kostë Çekrezit. Dyshimet e OSS për një marrëveshje të mundshme ndërmjet qeverisë britanike dhe qeverisë greke në emigracion, në lidhje me pretendimet territoriale greke ndaj Shqipërisë, ishin gjithashtu edhe ato të Çekrezit.⁴⁶ Në shtator 1941, Çekrezi kishte pasur kontakte direkte me disa përfaqësues të lartë të qeverisë greke e jugosllave në emigracion.

Departamenti i Shtetit ndonëse ishte në hapat e fundit të përgatitjes së deklaratës për njohjen e shtetit të pavarur shqiptar, nuk i anashkaloj vërejtjet

⁴⁴ *Po aty*, Roll 15, nr. 875.01/492. Memorandum bisede që sekretari Hull ia dërgon ambasadorit amerikan në Londër, zotit Anthony I. Drexel Biddle, më 8 dhjetor 1942.

⁴⁵ *Po aty*.

⁴⁶ NARA, RG 226, no. 21485. Memorandum i Zyrës së Shërbimeve Strategjike (OSS) ‘Albanian Politics in the United States’, 25 shtator 1942.

dhe rekomandimet e OSS. Departamenti i Shtetit nuk kishte ndonjë plan për të njohur as Zogun, as qeverinë e tij, por as edhe ndonjë Komitet apo Këshill të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ të Kostandin Çekrezit. Por, ajo që tërhoqi vëmendjen e diplomatëve amerikanë ishte dyshimi për zhvillimin e bisedimeve zyrtare ndërmjet qeverisë britanike dhe përfaqësuesve të qeverive greke e jugosllave në emigracion për ndarjen e Shqipërisë.

Këshilltari për politikën e jashtme në DSH, Wallace Murrey, më 4 dhjetor 1942, u përpoq t’u jepte përgjigje dyshimeve të Brannon-it.⁴⁷ Ai shprehu opinionin e vet se nuk kishte dijeni që qeveria britanike parashikonte ndarjen e Shqipërisë, dhe as për zhvillimin e bisedimeve greke e jugosllave për këtë çështje. Murrey e kundërshtoi idenë e njohjes së ndonjë apo të disa grupeve shqiptare në emigracion si përfaqësues të Shqipërisë. Ai e përjashtoi tërësisht grupin e përfaqësuar nga Faik Konica [Vatra], për shkak të justifikimit që i kishte bërë sulmit italian mbi Greqinë, ndërsa për Çekrezin diplomati amerikan mendonte se ai, ‘mund të mos ishte i pranueshëm nga shumica e shqiptarëve’. Mosnjohjen e Zogut, diplomati amerikan nuk e kushtëzonte me figurën e tij, sikurse Brannon, por me pretendimet e grupeve dhe personave të tjerë të ngjashëm me Zogun në Evropë. Duket se Murrey nuk donte të dilte jashtë kuadrit të gjykimit të qeverisë amerikane për njohjen e Zogut.

Më 8 dhjetor 1942, sekretari Hull ngarkoi ambasadorin amerikan në Londër, Anthony Drexel Biddle që të kërkonte sqarime tek qeveria britanike, në lidhje me dyshimet e OSS.⁴⁸ Sekretari i Shtetit i përmendte paraprakisht Biddle-it, se ‘Departamenti nuk kishte vënë re ndonjë aludim, se qeveria britanike mbështeste një projekt të tillë, por, nënvizonte ai, do të ishte i mirëpritur ndonjë informacion në lidhje me këtë çështje’. Hull gjykonte se paraqitja e një deklaratë serioze për Shqipërinë nuk mund të bazohej në supozime e dyshime.

Qeveria britanike më 3 dhjetor e kishte njoftuar Washington-in dhe një ditë më pas edhe qeverinë sovjetike, lidhur me vendimin e saj për të njohur pavarësinë e Shqipërisë.⁴⁹ Letra që iu dërgua qeverisë amerikane kishte disa ndryshime të rëndësishme nga ajo që ju përcoll qeverisë sovjetike. Qeverisë amerikane i bëhej e ditur shkurtimisht përmbajtja e deklaratës, arsyet e bërjes

⁴⁷ NARA, Roll 15, no. 875.01/467. Wallace Murrey për zotin Atherton dhe për zotin Berle, më 4 dhjetor 1942.

⁴⁸ *Po aty*, Roll 15, no. 875. 01/467. DSH për Biddle, 8 dhjetor 1942.

⁴⁹ TNA, FO 371/33107, No. 7584, FO për USA, 3 dhjetor 1942, f. 65; *po aty*, FO 371/33107, No. 372, f. 70, FO për BS, 4 dhjetor 1942.

së saj në këtë kohë, dhe data 9 dhjetor si kohë e shpalljes së saj në parlament. Letra përfundonte me shpresën dhe besimin se edhe deklarata amerikane do të ishte e ngjashme me atë të qeverisë së Madhërisë së Tij. Letra që iu dërgua Moskës më 4 dhjetor nuk merrej me arsyet se, pse qeveria britanike nuk e kishte bërë atë më herët, por pasqyronte të detajuar përmbajtjen e saj. Palës sovjetike i bëhej e ditur se deklarata britanike do të shpallej në parlament më 16 dhjetor dhe jo në datën 9, sikurse ishte njoftuar një ditë më parë Departamenti i Shtetit. Shpjegimet e gjera që iu dhanë amerikanëve, se, përse britanikët nuk e kishin bërë më parë deklaratën, dhe se, pse po e bënin tani, me sa duket u bënë për të qartësuar arsyet e qëndrimit të tyre të ndryshëm nga i qeverisë amerikane ndaj pushtimit dhe qeverisë së saj kuislinge. Qeveria britanike me sa duket nuk e pa të nevojshme që t'i jepte shpjegime të kësaj natyre edhe qeverisë sovjetike, e cila nuk kishte shfaqur ndonjë interes të posaçëm për të ardhmen e Shqipërisë, por as për ndonjë opsion të ndryshëm nga i saji.

Ambasadori Halifax, më 5 dhjetor i paraqiti sekretarit Hull letrën e FO për njohjen e Shqipërisë, dhe mori prej tij tekstin e deklaratës amerikane, e cila kishte të njëjtën përmbajtje sikurse ajo që Hull kishte prezantuar më 30 nëntor 1942 në konferencën e shtypit me gazetarët. Përveç letrës së Hull, lordi Halifax i përcolli FO edhe gjykimin e tij mbi draft-deklaratën amerikane, të cilën e cilësonte si mjaft të mirë. Ai shprehte sigurinë e tij se, Departamenti i Shtetit do ta mbështeste deklaratën e qeverisë britanike në Dhomën e Komuneve. Një ditë më pas Halifax e njoftoi DSH për ndryshimin e datës së shpalljes së deklaratës së qeverisë së tij në parlament për Shqipërinë, e cila do të paraqitej më 16 dhjetor 1942.

Më 10 dhjetor 1942, Cordell Hull bëri deklaratën e mëposhtme, në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë:

“Qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk është e pakujdesshme ndaj rezistencës së vazhdueshme të popullit shqiptar kundër forcave italiane të pushtimit. Përpjekja e çetave të ndryshme guerilje, që po veprojnë kundër armikut të përbashkët në Shqipëri është e admirueshme dhe e vlerësueshme. Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara e presin me padurim ditën kur mund t’u jepet ndihmë efektive këtyre burrave trima, për të përzënë pushtuesin nga shtëpitë e tyre. Në përputhje me politikën e saj për të mos njohur pushtimin territorial me forcë, qeveria e SHBA nuk e ka pranuar kurrë

aneksimin e Shqipërisë nga kurora italiane"⁵⁰. Deklarata e përbashkët e Presidentit dhe e Kryeministrit britanik, bërë më 14 gusht 1941, e njohur si Karta e Atlantikut, parashikon si më poshtë:

Ata respektojnë të drejtën e të gjithë popujve për të zgjedhur formën e qeverisë nën të cilën do të jetojnë, dhe dëshirojnë të shohin të drejtat sovrane dhe vetëqeverisjen të rikthyer, për ata që janë privuar me forcë prej tyre. Ringritja e Shqipërisë së lirë është e qenësishme në atë deklaratë parimore". (Këto të fundit janë shënime të gazetës).

Deklarata amerikane ishte surprizë për qeverinë britanike. Reagimi i parë ndaj saj erdhi nga ambasadori britanik në Washington, lordi Halifax më 10 dhjetor, ndërsa një ditë më vonë edhe nga Dixon në emër të FO.⁵¹ Të dy nuk ishin të kënaqur as me mënyrën si ishte formuluar deklarata e Departamentit të Shtetit, as me shpalljen e saj përpara britanikëve, dhe as me ndryshimet që kishte pësuar përmbajtja e saj brenda pak ditëve. Britanikët pretenduan se draft-deklarata amerikane për Shqipërinë, që u ishte bërë atyre e njohur më 5 dhjetor, kishte pësuar ndryshime nga ajo që u paraqit më 10 dhjetor nga Hull. Britanikëve nuk u pëlqeu thelbi i deklaratës, për dy arsye, sepse *së pari*, ai e lidhte të ardhmen e Shqipërisë me rezistencën aktuale të shqiptarëve, dhe *së dyti*, se ajo i referohej 'Kartës së Atlantikut'. Por, nuk u pëlqeu gjithashtu as fakti, që ajo ishte shpallur përpara se të shpallej deklarata e tyre, për të cilën ata kishin pasur iniciativën gjatë gjithë kohës. Britanikët mendonin se amerikanët duhej t'i kishin informuar në kohë, përpara se ta ndryshonin përmbajtjen e deklaratës, ose që deklaratat e të dy vendeve të ishin paraqitur në të njëjtën datë. Dixon komentonte se amerikanët në mënyrë të qëllimshme nuk u konsultuan me qeverinë britanike, por e njoftuan atë përmes telefonit, ndërkohë që deklarata ishte shpërndarë dhe bërë e njohur. "Ne, shkruante Dixon, kemi qenë shumë të shqetësuar që ata [amerikanët] nuk kanë qëndruar afër nesh në këtë ndërmarrje".⁵² Ajo që i digjte më shumë qeverisë britanike ishte fakti që deklarata amerikane e lidhte 'ndërtimin e Shqipërisë së lirë me Kartën e Atlantikut'. 'Do të kishte qenë e

⁵⁰ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), V. 1944, D. 17, fl. 5. Deklarata është shkruar në gjuhën angleze e frënge (TNA, FO 371/33113, Viti 1942), Marrë nga 'The New York Times', New York, 11 dhjetor 1942; NARA, Roll 15. "Political Affairs, Albania, Basic Handbook", gusht 1943.

⁵¹ TNA, FO 371/37107, f. 156-157. Telegram i Halifax për FO, 10 dhjetor 1942. Telegrami shoqërohet me komentet e Dixon, të datës 11 dhjetor 1942.

⁵² Po aty, f. 156.

dëshirueshme, theksonte Dixon në fund, që qeveria e Madhërisë së Tij dhe e SHBA të kishin folur me një zë të vetëm'.⁵³

Qeveria britanike në ditët në vijim i bëri dy kërkesa të njëpasnjëshme qeverisë amerikane dhe i propozoi asaj që të 'shprehte diçka më shumë në lidhje me lirinë e Shqipërisë', duke nënkuptuar përmirësimin e deklaratës së 10 dhjetorit dhe sjelljen e saj në një linjë me atë të tyre. Ambasadori britanik në Washington u përpoq ta justifikonte pretendimin e qeverisë së tij me ankesat greke, por edhe me disa pakënaqësi të shprehura në shtypin amerikan ndaj deklaratës së Hull. Halifax, nga ana tjetër, i bëri të qartë qeverisë britanike se atij nuk i ishte kërkuar më parë që amerikanët të bënin deklaratë të njëkohshme me të tyre dhe, se deklarata e datës 10 dhjetor nuk ishte bërë me qëllim të keq. Këmbënguljen e Londrës për të bërë një deklaratë të re ai e quajti të paarsyeshme. Por, Hull i refuzoi rregullimet e propozuara, si gjëra pa kuptim.⁵⁴ Veçanërisht e pakënaqur me deklaratën amerikane ishte qeveria greke në mërgim si dhe shoqatat e greko-amerikanëve në SHBA, të cilat kërkuan ta ndryshonin deklaratën e 10 dhjetorit dhe ta përtafronin përmbajtjen e saj me deklaratën e qeverisë britanike. Më 21 dhjetor, ambasadori i Greqisë, Cimon Diamantopulos u takua me nënsekretarin Welles dhe i dorëzoi një memorandum të qeverisë së tij.⁵⁵ Qeveria greke i propozonte qeverisë amerikane që të bënte një deklaratë tjetër të njëjtë me atë të britanikëve. Shqetësimi kryesor i saj mbetej çështja e kufijve me Shqipërinë. Por Welles e refuzoi kërkesën e Diamantopulous. "Kjo qeveri, nuk ka bërë dhe nuk ka marrë ndonjë angazhim sekret në lidhje me ndryshimet territoriale të ndonjë vendi tjetër..., se askush në Kombet e Bashkuara nuk do të bëjë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me këto rregullime, deri në përfundim të luftës".⁵⁶ Dy ditë më pas Departamenti i Çështjeve të Lindjes së Afërme e refuzoi kërkesën e qeverisë greke, për të bërë një deklaratë tjetër në lidhje me Shqipërinë dhe theksoi sërish idenë se, rregullimet territoriale do të bëheshin në fund të luftës.

Lidhja Kombëtare Pan-Epirote e grekëve të Amerikës ishte përpjekur më herët që të ndikonte në përmbajtjen e deklaratës së qeverisë amerikane. Më 3 dhjetor 1942, presidenti Basil Moulas dhe sekretari i Përgjithshëm, Constantine S. Dimas i kësaj organizate i drejtuan sekretarit Hull një letër të

⁵³ *Po aty*, f. 157

⁵⁴ *NARA*, Roll 15, no. 875.01/460. Takimi i Hull me Halifax, më 24 dhjetor 1942.

⁵⁵ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/459. Memorandum bisede i takimit të Welles me Cimon Diamantopulos, 21 dhjetor 1942.

⁵⁶ *Po aty*.

gjatë, të shoqëruar me një apendiks ‘me fakte’ e me komente fyese kundër Shqipërisë dhe shqiptarëve.⁵⁷ Thelbin e letrës e zinin pretendimet, se shqiptarëve historikisht u kishte munguar dhe u mungonte ndërgjegjia kombëtare, se ata nuk meritonin të trajtoheshin njëllor me kombet e tjerë në Ballkan, dhe se ‘Vorio-Epiri’ duhej t’i bashkohej Greqisë pas mbarimit të luftës. Pra, shoqata e mësipërme e pranonte idenë e krijimit të shtetit shqiptar të pasluftës, por pa Shqipërinë e Jugut, e cila duhej, sipas tyre, t’i bashkohej Greqisë. Krahas këtij propozimi kryesor, ajo parashitroi edhe dy opsione të tjera, të cilët nuk parashikonin ndryshime terriroresh, por vetëm shkëmbime popullsish. Shteti i pavarur shqiptar, sipas opsionit shtesë, duhej të vendosej për një periudhë të konsiderueshme kohe, nën mandatin direkt apo indirekt të një fuqie të paiteresuar në Ballkan. Gjithashtu, ai duhej të shoqërohej me një konventë, e cila do të parashikonte shkëmbimin e popullsisë greke e shqiptare, me qëllim që të mos kishte konfrontime ndërmjet dy shteteve. Si zgjidhje e dytë, propozohej krijimi i një federate greko-shqiptare. Memorandumi përfundonte me lutjen që qeveria amerikane të shmangte ndonjë gabim, i cili mund t’i privonte epirotët grekë nga liria për të cilën ata ishin torturuar e sakrifikuar. Pra, në të gjitha variantet ‘epirotët grekë’ do të bashkoheshin me Greqinë.⁵⁸

Departamenti i Shtetit iu përgjigj letrës së lartpërmendur pas shpalljes së deklaratës së 10 dhjetorit. Përgjigjja ishte formuluar me fraza standarde se ‘çështjes do t’i kushtohet vëmendje’. Ambasadorit britanik në Washington, më 9 dhjetor 1942 i ishte adresuar një kopje e deklaratës amerikane, që do të shpallej vetëm një ditë më pas nga sekretari Hull. Federata Pan Epirote ishte e pakënaqur me përmbajtjen e deklaratës së qeverisë amerikane. Halifax priste që grekët e Amerikës ta kundërshtonin atë me forcë. Ai i sugjeroi FO që ta diskutonte këtë problem me ambasadat greke e jugosllave në Washington.⁵⁹

Ditën që qeveria amerikane shpalli deklaratën për Shqipërinë, Lidhja Kombëtare Amerikane Pan-Epirote i dërgoi sekretarit Hull një material të titulluar ‘raport shtesë-Epiri i Veriut’.⁶⁰ Shoqata e grekëve të Amerikës shprehte gatishmërinë e saj që Departamenti i Shtetit të njihte ‘Shqipërinë e

⁵⁷ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/429. Memorandum i Lidhjes Kombëtare Pan-epirote drejtuar Cordel Hull, 3 dhjetor 1942.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ TNA, FO 371/33107, no. 5982. Telegram i Halifax për FO, 9 dhjetor 1942.

⁶⁰ *Po aty*, FO 371/33107, no. 875.01/436. Letër e Lidhjes Kombëtare Amerikane Pan-Epirote për Hull, 10 dhjetor 1942.

Lirë' dhe kryetarin e saj Kostandin Çekrezi, si 'një njeri që kishte peshë dhe influencë në morinë e krerëve shqiptarë'. Si kompensim për njohjen e 'Shqipërisë së Lirë' nga Departamenti i Shtetit, epirotët greko-amerikanë i kërkonin qeverisë së tyre, që të shprehej në favor të së ardhmes së greko-epirotëve të Shqipërisë, duke nënvizuar lindjen e keqkuptimeve tek grekët nëse ajo nuk bëhej. Lidhja Pan-Epirote e Amerikës ishte kundër njohjes së Nolit e Konicës nga DSH, për shkak se 'ata ishin financiar më parë nga Italia dhe më vonë nga Zogu, ndërsa Çekrezi nuk kishte përfitur nga Zogu'.⁶¹

Shoqata e greko-amerikanëve, sipas opinionit tim, nuk kishte ndonjë afeksion të veçantë ndaj Çekrezit dhe kauzës së tij, e cila ishte qartazi e pastër dhe kombëtare. Por, me sa duket ata e shfrytëzuan këtë rast për të paraqitur kërkesat e tyre në favor të çështjes së 'Vorio-Epirotëve', duke përdorur dinakërinë, pasi nuk ia kishin arritur qëllimit me mjete të tjera. As 'Shqipëria e Lirë', as Çekrezi dhe ca më pak 'Vatra' me Konicën e Nolin në krye nuk u shpëtuan akuzave e fajësimeve nga shoqata e grekëve të Amerikës.

Më 30 dhjetor 1942, Lidhja Kombëtare Pan-Epirote e grekëve të Amerikës iu drejtua Departamentit të Shtetit me një letër tjetër, përmes së cilës theksohej mbështetja për deklaratën e 10 dhjetorit për ringritjen e shtetit shqiptar të pasluftës. Në fakt, ata ishin të pakënaqur që ajo nuk e përmendte problemin e kufijve të Shqipërisë, për të cilët ata kishin pretendime. Por, ata zgjodhën të mos e atakonin direkt deklaratën, por indirekt i refuzuan disa pjesë të saj, duke sjellë në vëmendjen e qeverisë amerikane disa fakte e opinione kundërshtuese nga disa burime. Letra përmendte jo rastësisht deklaratën e qeverisë britanike për Shqipërinë, e cila ishte më e pranueshme se sa ajo e qeverisë amerikane. Ata iu referuan gjithashtu disa komenteve kritike të shtypit grek, të cilët nuk shihnin të pasqyruara pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut. Madje, nuk lanë pa u përmendur edhe interpretimet negative të kryeministrit shqiptar Mustafa Krujës, për të cilin 'deklaratat e tre të mëdhenjve propagandonin ndarjen e Shqipërisë me bekimin e tyre'. Kryeministri shqiptar shkruante në gazetën italiane *Relazioni Internazionale*: 'amerikanët nuk kanë interesa vitale në Ballkan, ndërsa Rusia dhe shtetet sllave do të predominojnë në Ballkanin e pasluftës nën fitoren e aleatëve'.⁶² Epirotët e Amerikës nuk donin të konfrontoheshin me qeverinë amerikane dhe zgjodhën metodën e pajtimit formal, por në thelb kundërshtues.

⁶¹ Nga dokumentet arkivore britanike dëshmohej se Çekrezi i kërkoi Zogut mbështetje financiare sapo ai krijoi 'Shqipërinë e Lirë', por nuk mori asgjë prej tij.

⁶² NARA, Roll 15, Target 2, no. 875.01/450. Letër e Harrison (Bernë) për Hull, 22 dhjetor 1942.

Deklarata e qeverisë amerikane për ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar u përshëndet nga “Vatra”, “Shqipëria e Lirë”, Zogu dhe nga miqtë e Shqipërisë në SHBA e Angli. Presidentit dhe sekretarit Hull iu dërguan me dhjetëra letra e telegrame. Por, krahas vlerësimeve dhe falënderimeve për deklaratën u kërkua avancimi i mëtejshëm i saj, me njohjen e Shqipërisë si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe garantimi i kufijve të saj. Në letrat e telegramet e ardhura nga Zogu, ‘Vatra’ dhe nga disa prej miqve të Shqipërisë në Angli u kërkua gjithashtu njohja e një qeverie në emigracion e kryesuar nga Zogu. Të tilla kërkesa erdhën nga degët e ‘Vatrës’ në New York, Detroit, Boston, East Pittsburgh, Braddock, Steubenville, Dearborn, Southbridge, Biddford, Pontas etj.⁶³ Disa degë të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ (Detroit, Ohio, New York etj.) i sugjeruan qeverisë amerikane që të njihte një qeveri shqiptare në mërgim me në krye Kostë Çekrezin.⁶⁴ Tekstet e letrave dhe telegrameve që iu dërguan presidentit Roosevelt dhe sekretarit Hull nga degët e ‘Vatrës’ e të ‘Shqipërisë së Lirë’ në qytetet e ndryshme të Amerikës u hartuan sipas modeleve të përgatitura nga Noli e Kostë Çekrezi.

Telegram falënderimi për deklaratën e 10 dhjetorit i dërgoi Sekretarit të Shtetit edhe grupi i shqiptarëve të Londrës i përbërë nga Perlat Bogdo, Dervish Duma, Anton Logoreci, Çatin Saraçi e Tajar Zavalani i shkruanin Hull-it, më 15 dhjetor: “Populli shqiptar është më shumë se mirënjohës, sepse siguria e parë për lirinë dhe të ardhmen vjen nga SHBA”.⁶⁵ Një telegram urimi për deklaratën e qeverisë amerikane iu dërgua Hull nga zonjusha Miram Tildesley në emër të miqve të Komitetit Shqiptar në Londër, më 13 dhjetor 1942. ‘Njohja e hershme e Shqipërisë si aleate dhe pranimi në Kombet e Bashkuara çon në rrugën e garantimit të independencës dhe të integritetit të saj të ardhshëm’.⁶⁶

Mjaft aktiv u tregua Noli. Më 16 dhjetor 1942, ai i dërgoi sekretarit Hull telegram falënderimi për deklaratën e 10 dhjetorit, në emrin e përfaqësuesit diplomatik të Zogut në Kajro, Abdyl Sulës, dhe në emër të

⁶³ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/479. Letër falënderimi drejtuar ‘Vatrës’ nga Hull, më 8 janar 1943.

⁶⁴ *Po aty*, Roll 15, no. 875.01/433. Telegram i John D.Steffan – kryetar i degës WUX-Somerville (Massachusetts) të ‘Shqipërisë së Lirë’ për Hull, 12 dhjetor 1942.

⁶⁵ *Po aty*, Roll 15, Telegram no. 875.01/437.

⁶⁶ *Po aty*, Roll 15, Telegram no. 875.01/432. Zonjusha Tuldesley ishte sekretare e shoqatës së krijuar me mbështetjen e njeriut të Zogut, zotit Kastrati - një shoqëri rivale me atë të ‘Miqve të Shqipërisë’, të kryesuar nga Aubry Herbert dhe Ledy Carnevon.

Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës.⁶⁷ Përcjellja e falënderimit të ministrit të Zogut nga Noli dëshmon për afrimin e këtij të fundit me Zogun, por edhe për ngurrimin e përfaqësuesit të mbretit shqiptar në Kajro për të komunikuar direkt me Departamentin e Shtetit. Përgjigjja e ndihmësshefit të Çështjeve Europiane Samuel Rober, ndaj mesazhit të Nolit ishte njëkohësisht surprizuese dhe inkurajuese. Ai jo vetëm që falënderonte Nolin si ndërmjetës, por i bënte të ditur se, ishte ngarkuar nga sekretari Hull, që përmes ministrit amerikan në Kajro të falënderonte Abdyl Sulën. Noli u mundua ta shfrytëzonte gjestin e mësipërm dhe ta konsideronte atë si njohje zyrtare të përfaqësuesit shqiptar nga ana e Departamentit të Shtetit. Ai u mundua gjithashtu që t'i rikujtonte qeverisë amerikane disa kërkesa të Zogut e 'Vatrës'. Ai i kërkoi sekretarit amerikan të Shtetit që të avanconte më tej me njohjen zyrtare të Zogut dhe të qeverisë së kryesuar prej tij në emigracion, me pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara dhe me garantimin e integritetit territorial të Shqipërisë.⁶⁸ Në fakt, falënderimi i Hull për Abdyl Sulën nuk i kalonte kufijtë e mirësjelljes diplomatike. Departamenti i Shtetit vazhdoi të mos njihte Zogun, dhe as përpjekjet e tij e të Nolit për të krijuar një qeveri në emigracion. Një marifet të tillë diplomatik, Noli e kishte bërë edhe me fjalimin mortor që mbajti në funeralin e Konicës, më 20 dhjetor 1942, kur e kishte cilësuar këtë të fundit si 'ambasador të Zogut në Amerikë'. Vetëm pak ditë më pas, Departamenti i Shtetit e përgënjeshtroi pohimin e Nolit.

Më 18 dhjetor 1942, Noli i dërgoi sekretarit Hull një telegram të gjatë në lidhje me deklaratën e 10 dhjetorit.⁶⁹ Ai e vlerësoi deklaratën e qeverisë amerikane si deklaratë të shkëlqyer të parimeve, por, sipas tij ajo do të mbetej 'letër e vdekur' po qe se nuk plotësohej më tej dhe të jepte siguri për dy çështje: *së pari*, të garantonte integritetin territorial të Shqipërisë dhe *së dyti*, të njihte Mbretin Zog, si 'drejtues logjik dhe legjitim të qeverisë shqiptare në mërgim, i cili do të drejtonte vendin deri në Konferencën e Paqes'. Noli kërkonte garanci zyrtare nga qeveria amerikane, sepse si shprehej ai, 'Greqia dhe Jugosllavia e kishin shpallur zyrtarisht qëllimin e tyre për ndarjen e Shqipërisë'. Noli e konsideronte Zogun viktimë të politikës së paqësimit me Musolinin në të kaluarën e afërt. Ai sulmonte ashpër kundërshtarët e kësaj ideje, duke u shprehur: 'në këtë gjendje emergjente disa që kundërshtojnë

⁶⁷ *Po aty*, Roll 15, Telegram No. 875.01/438.

⁶⁸ *TNA*, FO 371/37138, f. 65. Telegram i Fan Nolit drejtuar Hull më 1 maj 1943.

⁶⁹ *NARA*, Roll 15, Telegram No. 875.01/449.

Zogun janë duke luajtur pa vetëdije në duart e armiqve të Shqipërisë'. Kundërshtari më i madh i kësaj ideje ishte Çekrezi, të cilin ai e 'kryqëzonte'. 'Zoti Çekrezi, - shkruante Noli, - një zhongler i papërgjegjshëm, i paprincipitë dhe i paskrupullt, një panegjirist i monarkisë dhe agjent shtypi për 10 vjet i mbretit Zog, tani përfaqëson një minoritet të papërfillshëm e të painformuar në Amerikë, i cili mund të merret seriozisht si kampion i republikanizmit vetëm nga njerëzit që nuk kanë sens humori'.⁷⁰ Noli nuk ishte bërë mik me Zogun, por e shihte atë, si shkruan ai vetë 'si të keqen më të vogël, njohja e të cilit do të zgjaste deri në Konferencën e ardhshme të Paqes'. Ai propozonte që, shqiptarët të bashkoheshin rreth Frontit të Bashkuar, si rruga e vetme për Shqipërinë, por edhe për Kombet e Bashkuara.

Qëndrimi kritik i Nolit ndaj deklaratës amerikane dhe sidomos ndaj deklaratës së qeverisë britanike vazhdoi edhe më pas. Më 7 mars 1943, në fjalën e mbajtur prej tij në përkujtim të Konicës, [të cilën ai ia dërgoi edhe sekretarit Hull], shigjetonte deklaratën britanike: "Zoti Eden, përmendte Noli, na tregoi hapur tri gjëra: *së pari*, që Shqipëria nuk ka kufij; *së dyti*, që fati i Shqipërisë do të zgjidhet nga Jugosllavia e Greqia, që haptazi mbrojnë ndarjen e Shqipërisë, dhe *së treti*, që Shqipëria nuk do përfaqësohet në Konferencën e Paqes, e cila do të diskutojë për ndarjen e Shqipërisë".⁷¹ Më e keqja e kësaj, shprehej Noli, është se këtë implikim e gjejmë edhe tek deklaratat e zotit Hull dhe zotit Molotov. Deklarata e zotit Eden, i shkruante Noli sekretarit amerikan të Shtetit, më bëri mua më pesimist, se sa kur unë bisedova me ju në New York, 8 muaj më parë. "Ndoshta, shkruante jo pa ironi Noli, duke kujtuar përmbajtjen e deklaratës britanike, duhet të jemi mirënjohës ndaj tij, që ishte kaq i sinqertë dhe paralajmërues për rrezikun që i kanoset Shqipërisë, ndërsa deklaratat e zotit Hull dhe zotit Molotov mund të na vënë ne në gjumë, që të flemë në një parajsë imagjinare".⁷² Noli e krahasonte deklaratën britanike për pavarësinë e Shqipërisë me Traktatin e Fshehtë të Londrës. Çekrezi e shfrytëzoi fjalimin e Nolit dhe e akuzoi atë si proitalian. 'Vatra' e mbrojti Nolin nga akuzat e Çekrezit përmes një shkrimi të botuar në gazetën 'Dielli'. Në Departamentin e Shtetit nuk vunë re, gjithashtu, ndonjë paralele ndërmjet qëndrimit të mbajtur nga Noli dhe atij të mbajtur nga kryeministri shqiptar Mustafa Kruja dhe nga italianët.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ NARA, Roll 15, No.875.01/534. Memorandum 'Problemi i një qeverie të 'Shqipërisë së Lirë', përgatitur nga Foreign Nationality Group to OSS, 9 gusht 1943.

⁷² *Po aty*.

Departamenti i Shtetit vazhdoi që t'i referohej deklaratës së 10 dhjetorit deri në çlirimin e Shqipërisë. Ai nuk njohu asnjë lloj qeverie të krijuar nga shqiptarët jashtë dhe brenda vendit. Në mënyrë të vazhdueshme qeveria amerikane i porositi shqiptarët jashtë dhe brenda vendit që të bashkoheshin, gjë që nuk u arrit asnjëherë.

S u m m a r y

THE AMERICAN POLICY IN RELATION TO THE FUTURE OF ALBANIA 1941-1942

The article "*The American Policy in relation to the future of Albania, 1941-1942*" examines one of the most troublesome and uncertain periods of Albania's history, namely the Italian occupation of the country and its prospect at the end of the Second World War. This article deals particularly with the US government's policy towards Albania focusing on several peak moments such as: the non-recognition of the Italian occupation of Albania, the US-Albania relations after the issuing of the Atlantic Charter and the Charter of the United Nations [1 January 1942], and specifically after the Declaration of 10 December 1942, which issued the right for the re-establishment of the independent Albanian state at the end of the War. This short paper takes also under consideration the general policy of the USA and compares it to the one followed by the British government. Basically the US government's policy continued to preserve a positive and supportive attitude towards Albania and the Albanians, in contrast to the erratic attitude followed in several cases by the Great Britain's government. There are also examined the common and distinct aspects in the policies of these two countries based on the American and British archival sources. In addition, this paper will deal with the attitude of the Albanian diaspora, represented by prominent figures such as King Zog, Fan Noli and Kostandin Çekrezi, but also by simple Albanians who were highly sensitive towards the future fate of their father land. Although the American policy during this time was more appreciated than that of the British government, there was still reluctance, distrust and fear from future partition of the Albanian territories in favor of neighboring countries, in particular Greece.